



Prishtinë, 28 janar 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1090\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 paragrafi 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V\_869\_2016 të datës 14 dhjetor 2016 për shoqërinë N.N.“DILLI - COM”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V\_869\_2016 të datës 14 dhjetor 2016 për shoqërinë N.N.“DILLI - COM”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit, të datës 12.12.2018 të shoqërisë N.N.“DILLI - COM”, me adresë fshati Bresanë, Komuna e Dragashit, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2019 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë N.N.“DILLI - COM”, dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_869\_2016 të datës 14 dhjetor 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me **14 dhjetor 2019 për ndërtimin e Hidrocentralit.**

## A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 30.12.2015 nga shoqëria N.N.“DILLI - COM”, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga shoqëria N.N.“DILLI - COM”, ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmëri në për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar





Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_806\_2016 me datë 31 mars 2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

- ZRRE me datë 21.11.2016 nga shoqëria N.N.“DILLI - COM”, ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizimin Final, për ndërtim ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
  - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 14 dhjetor 2016 pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit, ka vendosur që shoqërisë N.N.“DILLI - COM”, ti lëshohet Autorizimi Final V\_869\_2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për ndërtim ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit.
  - ZRRE me datë 12.12.2018 nga shoqëria N.N.“DILLI - COM”, ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_869\_2016 të datës 14 dhjetor 2016, **për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 14 dhjetor 2019.**
  - Shoqëria N.N.“DILLI - COM”, ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizim, dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: ka përfunduar fazën e ndërtimit, objektin e centralit, veprën e marrjes, tubacionin si dhe linjën 10 kW, dhe janë në pritje të furnizimit me pajisjet elektromekanike, e cila për shkaqe teknike nuk ka mundur të liferoj brenda afateve të kërkuara.
  - Poashtu, ka sqaruar se vonesat janë shkaktuar për shkak se kompania Sllovene për prodhimin e turbinave është e mbingarkuar me punë, dhe deri më tani nuk ka mundur të na furnizojë me pajisjet elektromekanike të centralit sipas kontratës.
  - Andaj, kanë kërkuar që tu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Vendimit V\_869\_2016 i datës 14 dhjetor 2016, edhe për një afat shtesë prej një (1) viti, **gjegjësisht deri me 14 dhjetor 2019 për ndërtimin e Hidrocentralit.**
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës të shoqërisë N.N.“DILLI - COM”, për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, me kapacitet të instaluar prej 0.31 MW, në lokacionin ZK Bresanë, komuna e Dragashit, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_869\_2016 i datës 14 dhjetor 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim V\_869\_2016 i datës 14 dhjetor 2016, do të vlen deri me datë **14 dhjetor 2019**, dhe pas skadimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I., të



këtij vendimi, në rast se pala nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.